

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Albert Zogaj, kryetar i kolegjit, Gëzim LLulluni dhe Nora Bllaca Dula anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses R.B. nga fshati ..., Komuna e Pejës të cilën e përfaqëson i autorizuari H.N., avokat nga Peja, kundër të paditurës Xh.Sh. nga Peja Rr. "...", në afërsi të ..., të cilën e përfaqëson i autorizuari B.L. avokat nga Peja, për shkak të dorëzimit të paluajtshmërisë, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Pejë, C.nr.55/10, i datës 06.11.2012, në seancën jo publike të mbajtur me datë 26.02.2018, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të autorizuarit të të paditurës Xh.Sh. nga Peja Rr. "...", në afërsi të ..., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Pejë, C.nr.55/10, i datës 06.11.2012, VËRTETOHET.

## A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.55/10, i datës 06.11.2012, në pikën I (një) të dispozitivit e ka miratuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses R.B. nga fshati ..., Komuna e Pejës. Në pikën II (dy) të dispozitivit e ka detyruar të paditurën Xh.Sh. nga Peja Rr. "...", në afërsi të ..., që paditëses t'ia dorëzojë në posedim dhe shfrytëzim të pa penguar patundshmërinë e identifikuar si ngastër kadastrale me numër ... me kulturë shtëpi në sipërfaqe prej 0.02.00 ha, oborr e në sipërfaqen e përgjithshme prej 0.07.89 ha, në vendin e quajtur "... " nga fl.ps.nr. ..., si dhe t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 1.559,60 Euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi në dorëzim, e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi i autorizuari i të paditurës, në afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak së shkeljes së standardeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut për një proces gjyqësor të drejtë dhe të ligjshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vendimit mbi shpenzimet procedurale, me propozim që të aprovohet ankesa e të autorizuarit të të paditurës, ndërsa aktgjykimi i atakuar të ndryshohet duke e refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses ose aktgjykimin e atakuar ta prishë dhe lëndën ta kthejë në rigjykim dhe vendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur i autorizuari i paditëses me propozim bërë Gjykatës së Apelit që ankesën e të autorizuarit të të paditurës ta refuzojë në tërësi si të pabazuar, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta vërtetojë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të autorizuarit të të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja R.B. nga fshati ..., Komuna e Pejës, përmes të autorizuarit të saj me datë 08.03.2007, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi për dorëzimin e paluajtshmërisë kundër të paditurës Xh.Sh. nga Peja Rr. "...", në afërsi të ..., me të cilën ka kërkuar që të miratohet padia e paditëses dhe të detyrohet e paditura Xh.Sh. nga Peja Rr. "...", në afërsi të ..., që paditëses t'ia dorëzojë në posedim dhe shfrytëzim të pa penguar patundshmërinë e identifikuar si ngastër kadastrale me numër ... me kulturë shtëpi në sipërfaqe prej 0.02.00 ha, oborr e në sipërfaqen e përgjithshme prej 0.07.89 ha, në vendin e quajtur "... " nga fl.ps.nr. ..., si dhe t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 1.559,60 Euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi në dorëzim, e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse si dhe shqyrtimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.55/10, i datës 06.11.2012, me të cilën e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivishtë si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit gjykata ka theksuar se nuk ka qenë kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse fakti se paditësja R.B. e ka blerë patundshmërinë në vitin 1997 nga S.B. dhe S.B.2, që të dy nga më parë nga Peja, dhe se paditësja R.B. me anë të autorizuarit të saj Q.M. kanë lidhur kontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë e cila kontratë është vërtetuar në Gjykatën Komunale në Pejë, me numër Vr.nr.687/2007, e datës 02.02.2007, nga e cila vërtetohet se paditësja ka blerë patundshmërinë respektivisht ngastrën kadastrale me numër ..., me kulturë shtëpi në sipërfaqe prej 0.02.00 ha, oborr e në sipërfaqe prej 0.05.00 ha dhe pemishte në sipërfaqe prej 0.00.89 ha, që gjithsejtë; e arrijnë sipërfaqen prej 0.07.89 ha, në vendin e quajtur "...", nga fleta poseduese me nr. ..., me çmim prej 70.000 DM të atëhershme, ku fillimisht në cilësi të blerësit është paraqitur S Sh.. ku edhe ka deklaruar se këtë patundshmëri e ka blerë për paditësen R.B. e cila në kohën e lidhjes së kontratës por edhe sot jeton në botën e jashtme në Gjermani.

Gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike ka bërë administrimin e provave të cilave i'a fali besimin si kontratës mbi shitblerjen e cila është vërtetuar në Gjykatën Komunale në Pejë, me numër Vr.nr.687/2007, e datës 02.02.2007, ku vërtetohet se paditësja në vitin 1997 e ka blerë patundshmërinë kontestuese. Ka shtuar se deri te

vërtetimi i gjendjes faktike ka ardhur edhe me dëgjimin e dëshmitarëve si dhe nga deklaratimet e vet të paditurës Xh.Sh., në shkresat e lëndës C.nr.548/08, në të cilat janë dëgjuar në cilësi të dëshmitarëve A.K., R.K., B.G. dhe I.G. dhe është argumentuar rrethana se S.Sh. ia ka dorëzuar të hollat në emër të çmimit të shitblerjes për patundshmërinë kontestuese A.K., i cili në atë kohë e ka pasur cilësinë e ndërmjetësuesit dhe kontrata nuk është legalizuar në atë kohë për faktin se është dashur të merret pëlqimi nga Ministria e Financave të ish pushtetit. Dëshmitari A.K. në momentin e marrjes së pëlqimit nga Ministria e Financave dhe me rastin e tentimit që të lidhë kontratë nuk ka mundur të lidhë kontratë për faktin se referenti i kësaj gjykate të asaj kohë pra në vitin 1998, ka refuzuar që ta vërtetojë një kontratë të tillë për faktin e mungesës së pronarëve, dhe se ish pronarët kanë refuzuar në atë kohë që të vinë dhe ta vërtetojnë kontratën nga shkakun se kanë qenë të sëmura, mirëpo gjykata pas analizimit të deklaratave të ish pronarëve ka vërtetuar se arsyeja e mos ardhjes për legalizimin e kontratës është arsyeja se ndërmjetësuesi këtu dëshmitari A. nuk ia ka dorëzuar të gjitha të hollat e çmimit kushtues, dhe të njëjtat pas pranimit të shumës prej 35.000 Euro, e kanë autorizuar Q.M. për shitblerjen e patundshmërisë kontestuese.

Ka shtuar se të drejtën e pronësisë e ka argumentuar dhe të njëjtën të drejtë e ka fituar nga baza e shitblerjes, me anë të lidhjes së kontratës në formë të shkruar dhe legalizimin e të njëjtës në gjykatën kompetente dhe me regjistrimin e të njëjtës në Drejtorinë për Gjeodezi Pronësi dhe Kadastër në Pejë.

Gjykata i ka vlerësuar edhe kundërshtimet e të paditurës se patundshmërinë kontestuese e ka blerë diku në vitin 1985 ose 1986 dhe se e ka përmbytur pjesërisht detyrimin që rrjedh nga ky raport kontraktual duke paguar shumën prej 16.000 DM, të atëhershëm mirëpo këto kundërshtime janë të pabazuara për faktin se as vetë e paditura e as dëshmitarët e dëgjuar të propozuara nga e paditura si Sh.Sh., Z.K., D.B., S.G., nuk kanë mundur ta argumentojnë se i ndjeri S. bashkëshorti i të paditurës ka lidhur kontratë me ish pronarët dhe as ta argumentojnë shumën e dorëzuar në emër të çmimit të shitblerjes për këtë patundshmëri.

Kundërshtimet e të autorizuarit të të paditurës se paditësja nuk mund të kërkojë kthimin e paluajtshmërisë me arsyetim se në momentin e lidhjes së kontratës nuk e ka marrë në posedim këtë paluajtshmëri janë të pasakta, sepse këtu kemi të bëjmë me dorëzimin e sendit të paluajtshëm e jo të sendit të luajtshëm, ngase te sendet e luajtshme element konstituiv i fitimit të pronësisë është dorëzimi i sendit, ndërsa te paluajtshmëritë është lidhja e kontratës në formë të paraparë me ligj dhe regjistrimi në librat publik. Gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar pretendimet e të paditurës lidhur me ekzistimin e gjyqëvarësisë, për faktin se në rastin konkret paditë e iniciuar nga Q.M. janë padi nga baza e vërtetimit të pronësisë nga të cilat i njëjti është tërhequr andaj edhe nuk kemi të bëjmë me gjyqëvarësi.

Në këtë rast nuk ekziston identiteti objektiv dhe subjektiv i kërkesëpadiës së paditëses me rastet e shqyrtuara e të cilat udhëhiqen në shkresat e lëndës C.nr.548/08 dhe 191/00, sepse në proceset e zhvilluara në kontestet me shenjën C.br.548/08, dhe 191/00, paditës paraqitet Q.M., sipas bazës juridike vërtetimi i të drejtës së pronësisë, ndërsa në rastin konkret kërkesa është e orientuar nga baza e dorëzimit të patundshmërisë.

Vendimin për shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452, 463 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkeljet tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat janë pretenduar me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit.

Në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Aktgjykimi i atakuar me ankesë është i rregullt në pikëpamje të strukturës dhe përmbajtjes duke përfaqësuar kështu një vendim i cili është koherent në pikëpamje logjike dhe juridike duke eliminuar çfarëdo kontradikte për ta kualifikuar si kundërthënë. Mënyra e zhvillimit të procedurës dhe e hartimit të vendimit nga gjykata e shkallës së parë kanë garantuar një proces të drejtë dhe të paanshëm duke u mbështetur për përfundimin e saj në themelin faktik dhe juridik të çështjes. Gjykata është thëlluar në procesin kontestimor të palëve ndërgjyqësore dhe nga faktet e konstatuara ka arrit të jap arsye të mjaftueshme për përputhshmërinë e gjendjes faktike të rastit konkret, me gjendjen faktike hipotetike të normës juridike sipas të cilës është përcaktuar edhe pasoja juridike, në këtë dhënia e mbrojtjes gjyqësore për të drejtën subjektive të cenuar sipas përmbajtjes në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar. Përveç kësaj në arsyetim të aktgjykimit gjykata ka treguar edhe normat materialo-juridike të zbatuara për përfundimin e saj, me çka plotëson edhe kërkesën e nenit 160 paragrafi 5 të LPK-së.

Në lidhje me pretendimin për ekzistimin e gjyqëvarësisë së dyfishtë, Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret nuk mund të bëhet fjalë për gjyqëvarësi të dyfishtë, sepse në kuptim të dispozitës së nenit 262 paragrafi 3, përcaktohet se: *“Gjatë kohës së ekzistimit të gjyqëvarësisë për të njëjtën kërkesëpadi nuk mund të iniciohet gjykimi i ri midis palëve të njëjta. Po që se, prapëseprapë, bëhet një gjë e tillë, gjykata e hedh poshtë padinë”*, andaj në rastin konkret nuk bëhet fjalë për palë

të njëjta. Edhe po të ekziston në zhvillim procesi i vëllait të paditëses, pavarësisht se tani nuk është kontestuese se i njëjti e ka tërhequr padinë, përsëri nuk do të përfaqësojë gjyqëvarësi të dyfishtë, madje as nuk do të kishte pengesa tjera për zhvillimin e gjykimit, pasi që në çdo rast aktgjykimi do të prodhonte efekte në mes të palëve të përfshira në kontest, respektivisht palëve ndërgjyqësore.

Në funksion të sigurisë juridike nëse zhvillohen më shumë konteste për objekt të njëjtë kontesti, por me subjekt të ndryshëm, apo me njërën prej palëve ë njëjtë për të gjitha gjykimet edhe mund të ndodhë bashkimi i kontesteve nëse gjykata e vlerëson se ka mundësi procedurale të bëhet bashkimi pa cenuar ndonjërin nga proceset gjyqësore në kontekstin e shkaktimit të vonësave të paarsyeshme dhe po që se bindet se proceduar e bashkuar mund të përfundoj me shpenzime me të vogla (neni 408) po që se plotësohen edhe kushtet tjera, në të kundërtën asnjë dispozitë ligjore nuk cenohet nëse zhvillohen konteste të ndara kur subjektet janë të ndryshëm. Kjo për faktin se një vendim i formës së prerë do të përfaqësoj “*gjë të gjykuar*” vetëm për kërkesën e paditësit dhe vetëm në mes të ndërgjyqësoreve dhe gjithashtu asnjë vendim meritore në mes të palëve të caktuara ndërgjyqësore në mënyrë parimore nuk e prejudikon përfundimin e asnjë procesi gjyqësor në mes të palëve të ndryshme.

Gjykata e Apelit e ka vlerësuar edhe pretendimin ankimor se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga shkak se nuk ka vendosur për kundërpadinë e të paditurës, por një pretendim të tillë nuk e ka pranuar si të bazuar. Gjykata e Apelit gjen se i autorizuari i të paditurës në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim në gjykatë e ka paraqitur kundërpadinë, andaj në kuptim të dispozitave nga 256 i LPK-së, nuk mund të konsiderohet si parashtrim i rregullt i kundërpadisë.

Me dispozita e nenit 425 është përcaktuar rrjedha e shqyrtimit kryesor, dhe në mënyrë specifike me dispozitën e nenit 425 paragrafi 1, pika f) e LPK-së, është përcaktuar se: “*pas marrjes së të gjitha provave, të dy palët, por se pari paditësi e mandej i padituri, i drejtohen gjykatës me shpjegime përfundimtare, me të cilat i përmbledhin aspektet faktike dhe juridike të çështjes kryesore*”. Nga interpretimi i dispozitës së cituar në mënyrë krejtësisht të qartë del se palët mund të deklarohen për aspekte faktike dhe juridike të çështjes por në këtë fazë të procedurës është e pamundshme paraqitja e kërkesave, e provave apo edhe e prapësimeve tjera procedurale për të cilat gjykata duhet të vendos. Në këtë kuptim vlerësohet se dorëzimi i fjalës përfundimtare me shkrim nga ana e të autorizuarit të të paditurës është me efekt dhe e vlefshëm vetëm në pjesën e gjendjes faktike dhe juridike të shqyrtuar nga gjykata, por është pa asnjë efekt pjesa e parashtrësës me të cilën jepen propozime në tipin e kundërpadisë, andaj Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar në duke mos marrë aktvendim për lejimin apo refuzimin e lejimit të kundërpadisë. Është në detyrën e gjykatës të vendos për natyrën e të tillë të kërkesave kur ato paraqitën në fazën kur procesi është ende në shqyrtim.

I autorizuari i të paditurës nuk e ka kundërshtuar në mënyrë specifike aktgjykimin sa i përket bazës ankimore për gjendjen faktike, por disa aspekte faktike të çështjes kontestuese i ka adresuar të baza ankimore zbatim i gabuar i të drejtës materiale, andaj edhe Gjykata e Apelit duke qenë se nuk e shikon sipas detyrës zyrtare gjendjen faktike, do të kufizohet në dhënien e arsyeve në mënyrë të veçantë për këtë bazë

ankimore, ndërsa në pjesën e arsyeve për zbatimin e të drejtës materiale di t'i trajtoj edhe ato çështje që lidhen me zbatimin e normave materiale në raport me gjendjen faktike.

Përkitazi me zbatimin e të drejtës materiale Gjykata e Apelit e pranon në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë, me arsyetim se në rastin konkret gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë është në pajtim me të drejtën materiale të referuar nga ajo gjykata, nga ka rrjedhur edhe përfundimin meritor i kësaj çështje kontestuese. Në këtë rast gjykata i është referuar dispozitës së nenit 37 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore, nga rrjedh e drejta e pronarit për ta kërkuar nga mbajtësi kthimin e sendit të caktuar në mënyrë individuale. Në rastin konkret në mënyrë të pakontestueshme është provuar se paditësja është pronare e patundshmërisë kontestuese e regjistruar në regjistrin për të drejtat në pronën e paluajtshme dhe e drejta e pronësisë nga ana e saj sa i përket kërkesës për dorëzimin e pronës është dëshmuar para gjykatës me titull të vlefshëm pronësie. Në këtë kuptim janë të pathemelta pretendimet e të autorizuarit të të paditurës se paditësja fillimisht është dashtë t'a provoj të drejtën e pronësisë e pastaj të kërkojë lirimin e pronës. Është pikërisht e drejta e pronësisë e cila përfaqëson autorizimin për pronarin që t'a mbajë, t'a përdorë dhe t'a disponoj sendin, që i ka krijuar bazën paditëses që me padi të kërkojë mbrojtjen duke kërkuar dorëzimin e sendit në posedim. Nuk do të ishte e pranueshme kërkesëpadija e paditëses për të drejtën e pronësisë (*nëse do të paraqitej*) sepse do të hedhej në mungesë të interesit juridik, përderisa e njëjta është pronare e patundshmërisë kontestuese e regjistruar si pronare.

Duke qenë se gjykata vendos për kërkesat e palëve dhe brenda kërkesave të tyre, dhe nisur nga fakti se në rastin konkret është vendosur vetëm për kërkesëpadinë e paditëses e cila para gjykatës në cilësinë e paditëses nga e drejta e pronësisë ka kërkuar dorëzimin e sendit si autorizim që rrjedh nga pronësia, i'a ka kufizuar gjykatës mundësinë të vlerësoj tërësinë e rrethanave faktike dhe juridike të cilat potencialisht po të kishte kërkesë nga pala e paditur do të mund të përfaqësonin titull posedimi apo pronësie që pastaj do ta detyronte gjykatës sa i përket posedimit të vlerësojë pushtetin më të fortë, prandaj në mungesë të një kundërkërkesë nga e paditura, e drejta e pronësisë e konstatuar për paditësen në procedurën e të provuarit si fakt sa i përket ekzistimit të titullit formal për pronësinë, e ka diktuar në mënyrë ligjore pasojën juridike dhe rrjedhimisht fatin e kërkesëpadiës.

Ashtu siç ka arsyetuar gjykata e shkallës së parë edhe sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit për qarkullimin e patundshmërive nuk është kusht i cili duhet të plotësohet në mënyrë kumulative me kushtet tjera dorëzimi i pronësisë, por janë puna juridike e vlefshme dhe regjistrimi, andaj mbi këtë vlerësim kjo gjykatë i vlerëson të pathemelta pretendimet e të autorizuarit të të paditurës sa i përket kësaj rrethane.

Kjo gjykatë i ka vlerësuar edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore por i ka vlerësuar me arsyetimin e njëjtë si gjykata e shkallës së parë si të pathemelta dhe pa ndikime për të vendosur ndryshe në këtë çështje juridike kontestuese. Në këtë kontekst është vlerësuar edhe pretendimi se vëllai i paditëses është paraqitur në një procedurë tjetër si paditës e cila ka përfunduar me tërheqje të padisë, por është konsideruar rrethanë e parëndësishme sepse në këtë rast nuk është vendosur lidhur

me padinë e paditëses në relacion me subjekt tjerë, por vetëm në relacion me të paditurën ndaj të cilës ka rezultuar si e themeltë kërkesëpadia.

Për nevoja të praktikës gjyqësore kjo gjykatë thekson se përfundimi i kësaj çështje me vendim të formës së prerë nuk e prejudikon vendosjen e asnjë kërkesë në çfarëdo procedure dhe rrjedhimisht përbën “*gjë të gjykuar*” vetëm për kërkesën e paditëses në raport me të paditurën. Përfundimi meritor në këtë çështje është vlerësim i rrethanave të prezantuara para gjykatës dhe të vlerësuar në relacionin e mbrojtjes gjyqësore të kërkuar nga paditësja në raport me të paditurën, prandaj efekti i aktgjykimit parimisht shtrihet vetëm në mes tyre dhe përbën “*gjë të gjykuar*” vetëm për kërkesën e gjykuar.

Pretendimet e të autorizuarit të të paditurës se patundshmërinë kontestuese e ka blerë paraardhësi juridik i të paditurës në vitin 1987, në këtë rast si rrethanë nuk përfaqëson bazë për një vendim ndryshe sepse baza e shitblerjes në mënyrë parimore përfaqëson titull të vlefshëm për bartjen e pronësisë vetëm nëse i nënshtrohet procedurës formale që nënkupton kontratën formale, e legalizuar-noterizuar dhe e regjistruar, ndërsa në raste tjera raporti joformal mund të përbëjë bazë vetëm për mirëbesimin në posedim, por i cili posedim edhe po të ekzistojë do të jetë i vlefshëm vetëm në raport me pretenduesit me autorizime më të ulëta, e jo edhe për pronarin, përderisa mirëbesimi nuk formatizohet me vendim gjykate si bazë për të drejtën e pronësisë dhe rrjedhimisht edhe për regjistrimin e pronësisë.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës Gjykata e Apelit vlerësoi se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë lidhur me shumën e shpenzimeve duke i arsyetuar shpenzimet e gjykuara për secilin veprim të ndërmarrë në procedurën kontestimore, e të cilat veprime edhe sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit kanë qenë të domosdoshme në mënyrën që gjykata e shkallës së parë të vendosë për themelësinë e kërkesëpadisë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Ac.nr. 412/13, me datë 26.02.2018

Kryetari i kolegjit  
Albert Zogaj, d.v